



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1888/ 8 prot.

Datë 13.09.2023

V E N D I M
Nr. 900/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.09.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës elektronike me nr. A/2023/3330, datë 01.08.2023 dhe me nr. 1888/2023 prot., më datë 01.08.2023, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “*Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)*”, me fond limit 379,248,000 (*treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK me NIPT K91628013D, me adresë rruga “Asim Vokshi”, Pallati Alb Building, kt. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 33, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.05.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”, me fond limit 379,248,000

(*treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 23.06.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 24.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alko Impex Konstruktion” SHPK	333.720.000	lekë	skualifikuar
2. “Salillari” SHPK	339.375.000	lekë	skualifikuar
3. “4 AM” SHPK	378.228.000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 31.07.2023 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “4 AM” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 01.08.2023, operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Konstruktion” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, ankesën me nr. A/2023/3330, datë 01.08.2023 dhe me nr. 1888/2023 prot., më datë 01.08.2023, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij për mospërbushje të kriterëve me përmbajtje si më poshtë vijon:

[....] Operatori ekonomik “Alko Impex Construction” nuk kualifikohet, pasi nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt-kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) *Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e transportit)*
- 1 (një) *Inxhinier Mekanik / Elektrik / Elektronik*

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së*

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtimesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

*** Staf i teknik i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e shërbimeve / punimeve objekt-kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Elektronik

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

*** Staf i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Nuk përmbush kapacitetet teknike pika 2.3.4 dhe pika 2.3.5 perkatesisht disponimi i stafit kryesor, stafi mbështetës. Staf i deklaruar në këto procedura është i angazhuar në kontrata të tjera.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: Shtojca 8 (shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik) Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit. Gjithashtu në DST nga AK është parashikuar se: shënim: në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 për Prokurimin Publikë si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i

ndryshuar. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: - Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik Alko Impex Construction dshh, ku në deklaratën B për disponimin e punonjësve të nevojshme është plotësuar plotësisht për sa i përket plotësimin të punonjësve të kërkuara. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë përcaktohet se: 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë përcaktohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.. Në nenin 26 formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,

Në formularin përmbledhës, në seksionin D, deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera, OE ankimes ka deklaruar:

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Nese do te shpallemi fitues, Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

1. Ermand Mataj, me profesion Inxhinier Ndertimi (Profili Infrastruktura Transporti) i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik.

2. Durim Hakrama, me profesion Inxhinier Mekanik i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e drejtuesit Teknik.

3. Diana Dinoshi, me profesion Inxhinierë Elektrik e punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin e drejtuesit Teknik.
4. Klodiana Kamberi me profesion Inxhinierë Gjeodet e punësuar pranë shoqërisë sone e pajisur me certifikatën përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
5. Florian Shehu, me profesion Ekspert Zjarrfikës i punësuar pranë shoqërisë sone.
6. Jurilda Ramushi me profesion Asistente zyre e punësuar pranë shoqërisë sone.
7. Erjon Muharremi me profesion Elektricitist i punësuar pranë shoqërisë sone.
8. Zamir Sherifi me profesion Elektricitist i punësuar pranë shoqërisë sone.
9. Arditian Sakollari me profesion Mekanik i punësuar pranë shoqërisë sone.
10. Indrit Emini me profesion Mekanik i punësuar pranë shoqërisë sone.
11. Kadri Fusha me profesion Hidraulik i punësuar pranë shoqërisë sone.
12. Islam Beba me profesion Shofer i mjeteve të rënda i punësuar pranë shoqërisë sone.
13. Flogert Beba me profesion Shofer i mjeteve të rënda i punësuar pranë shoqërisë sone.
14. Arben Blloshmi me profesion Shofer i mjeteve të rënda i punësuar pranë shoqërisë sone.
15. Englisson Demiri me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë sone.
16. Gjergji Stathi me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë sone.
17. Arben Deliu me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë sone.

Etj .,

Nese do te shpallemi fitues ,punonjesit e deklaruar nuk do te jene te angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. Gjithashtu, nga OE ankimes janë dorëzuar dhe deklaratat e mëposhtme të lëshuara nga administratori i shoqërisë i cili deklaroi se: unë i nënshkruari A A me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Alko Impex Construction deklaroi se: në procedurën me Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt Mirëmbajtje Tuneli i krrabës (2023-2027) në rast se shpallemi fitues, punonjesit e deklaruar do të jene te pranishem gjate gjithë kohes ne objekt dhe do te jene te angazhuar vetem ne kete kontrate dhe jo ne kontrata te tjera. Ndërkohë në pikën 4 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285/2021 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publikë i ndryshuar, parashikohet: për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit perkates dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për

ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose Sa më sipër, ligjvënësi ka parashikuar se për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë përkatëse autoriteti kontraktor mund të kërkojë listë të stafit për të zbatuar objektin e prokurimit dhe nëpërmjet deklaratimit të bërë si në formularin përmbledhës dhe deklaratën e lëshuar nga administratori i shoqërisë provohet se OE ankimues disponon stafin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, staf i cili do të disponibël gjatë gjithë kohës nëse OE ankimues shpallet fitues i procedurës së sipërcituar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon [...]

II.6. Bazuar në nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1888/2 prot., datë 01.08.2023, u publikuan arsyet e skualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK kundërshton nëpërmjet ankesës së tij.

II.7.. Me shkresën nr. 6485/3 prot., datën 04.08.2023, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik, me shkresën nr. 1888/4 prot, datë 08.08.2023, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, si dhe kthim-përgjigjja e operatorit ekonomik ankimues lidhur me trajtimin e ankesës së tij, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur mospranimin e ankesës me përmbajtje si më poshtë vijon:

[.....]

III. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë ankesë komisioni i shqyrtimit të ankesave vëren se:

Nga KVO dhe nga KSHA është kryer evidentimi i stafit në të gjitha kontratat aktive me ARRSH për secilin operatorë pjesëmarrës në këtë procedurë. Në bazë të këtij verifikimi rezulton se stafi i deklaruar në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje tuneli i Krrabës (2023-2027) nga operatori ekonomik pjesëmarrës Alko Impex Construction ShPK është i angazhuar në një kontratë tjetër në proces zbatimi me Autoritetin Kontraktor (ARRSH), ky evidentim është kryer në përputhje me VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, konkretisht nenin 26 dhe 82 të saj.

Për sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës bazuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka verifikuar vërtetësinë e këtij deklarimi dhe gjykon se pretendimi juaj nuk qëndron.

IV. Vendimi i komisionit të shqyrtimit të ankesës:

Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Konstruktion” ShPK për procedurën me objekt “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”, me fond limit 379,248,000 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë) lekë pa TVSH, me REF-69747-05-19-2023.[...]

II.8. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkresës nr. 1888/5 prot., datë 29.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion të detajuar mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi në përputhje me nenin 114 të LPP-së.

II.9. Me anë të shkresës Nr. 6941/1 prot., datë 31.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 1888/6 prot., datë 04.09.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin në lidhje me procedurën e prokurimit së bashku me CD.

II.10. Me shkresën e datës 13.09.2023 me objekt “Heqje dorë nga shqyrtimi i ankesës për procedurën e prokurimit me objekt ‘Mirëmbajtja e tunelit të Krrabës (2023-2027)’”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me shkresën nr. 1888/7 prot., datë 13.09.2023, operatori ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë për tërheqjen nga ankesa për procedurën e mësipërme të prokurimit. Në kërkesën e mësipërme operatori ekonomik ankimues citon: “*Pranë Komisionit Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa e paraqitur nga shoqëria Alko Impex Construction me palë dhe objekt si më poshtë, Autoritet Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar, Objekti Procedurës: Mirëmbajtja e tunelit Krrabës (2023-2027)*”. Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së, deklaroj dhe kërkoj Heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur si më sipër cituar”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 1888/7 prot, datë 13.09.2023, me objekt heqje dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e

Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “*Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)*”, me fond limit 379,248,000 (*treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” ku përcaktohet se “*1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.*” dhe parashikimeve të nenit 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt-ankimimin e tij, dhe si pasojë mosshqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë vetë ankimuesi shpreh vullnetin e tij të lirë për t’u tërhequr nga ankesa të cilën ligjvënësi e ka përcaktuar si një mjet ligjor për t’i ardhur në ndihmë operatorëve ekonomikë të cilëve u janë prekur ose mund t’i preken interesat nga vendimet e autoritetit kontraktor, dhe për sa kohë që ankimuesi nuk shfaq më interes për procedurën e prokurimit në bazë të kërkesës së bërë, atëherë ankesa e bërë prej tij e humbet qëllimin e saj si një mjet ligjor nëpërmjet të cilit operatorët ekonomikë mund të realizonin qëllimin e tyre, për t’u shpallur fitues një procedurë prokurimi. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik “*Alko Impex Construction*” SHPK për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 1888 prot, datë 01.08.2023, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur - Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-69747-05-19-2023, me objekt “Mirëmbajtje Tuneli i Krrabës (2023-2027)”, me fond limit 379,248,000 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri